

## **PLATFORMË E QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE PËR KANDIDIM SI ANËTAR I KËSHILLIT TË LARTË PROKURORISË**

Unë Moisi Duda, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës se Apelit Durrës, në bazë të nenit 108/3, gërmë “ç” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” duke qenë se, kam vendosur të kandidoj për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) parashtroj arsyet që më shtynë të ndërmarr këtë iniciativë, duke bërë të njohura përmes kësaj platforme personale qëllimet dhe objektivat që kërkoj të realizoj me qënien time si anëtar i KLP-së.

Ndryshimet kushtetuese dhe ligji nr.115, datë 03.11.2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i kanë dhënë rol shumë të rëndësishëm Këshillit të Lartë të Prokurorisë, mbi drejtimin, organizimin dhe mbarëvajtjen e punës së organit të Akuzës, nisur nga kompetencat e reja që i janë dhënë këtij insitucioni.

Gjatë karrierës time të gjatë si prokuror jam përpjekur të ushtrojë detyrën time me përgjegjësi, profesionalizëm, guxim, ndershëmëri dhe përkushtim maksimal. Duke mbajtur këtë detyrë si gjithë secili prej nesh jam gjendur edhe përpara situatash presioni, keqgjykimi dhe paragjykimi, që sigurisht kanë patur ndikim tek unë si njeri i ligjit, por gjithsesi nuk kanë mposhtur forcën për të qenë kah së drejtës dhe të vërtetës. Në bindjen time qëllimi kryesor i punës së prokurorit është mbrojtja e interesave të ligjshme të shtetit dhe shtetasve dhe garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të individëve, por sigurisht që ky qëllim nuk përbushet nëse prokurorit nuk i krijojnë kushte dhe mundësi që të ushtrojë detyrën pa qenë i ndikuar dhe pa presione të cdo lloj natyre. Përbushja e këtyra objektivave të rëndësishëm, do të jetë synimi kryesor i platformës time.

Anëtarët e KLP-së kanë për detyrë të marrin masat për zbatimin e Kushtetutës dhe ligjit, si dhe hartojnë rregulla e mbikëqyrin zbatimin e tyre, në funksion të kompetencave të parashikuara nga paketa e re ligjore. Këto detyra si kandidat për anëtar i KLP-së, marr angazhimin se, do i përbush përmes realizimit të qëllimeve dhe objektivave të mëposhtme:

1. Zbatimi me përpikmëri i rregulloreve tashmë të miratuar nga KLP-ja, si dhe angazhimi maksimal në përsosjen e mëtejshme të këtyre në varësi të problematikave që do të lidnin në të ardhnen, kjo me qëllim garantimin efektiv të Pavarësisë së Prokurorit nga njëra anë dhe vendosjen e mekanizmave eficiente per kontrollin efektiv të punës së prokurorit nga ana tjeter;
2. Perpjekje maksimale në respektimin e te drejtave të prokurorëve që rrjedhin nga ligji me qëllim zhvillimin e karrieres se tyre mbi bazen e parimit të meritokracisë, barazisë dhe vlerave me të larta njerezore, etike dhe profesionale.
3. Mbeshtetja pa rezerva e prokurorëve që kryejnë me perkushtim detyrën, ndaj sulmeve të padrejta të Medias apo individëve të veçantë që cënojnë integritetin e

prokurorëve,kjo edhe në vazhdim të qëndrimit mbështetës të KLP-se në raste të tillë të ngjashme.

4. Përkuantim maksimal në krijimin e mundesive dhe hapesirave që bëjnë të mundur krijimin e kushteve optimale për të kryer me efektivitet detyrën e prokurorit.
5. Në funksion të zbatimit të ligjit, e shoh me shumë rëndësi forcimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese.
6. Vlerësim me objektivitet maksimal i rasteve të përcjella per shqyrtim nga ana e ILD-se,duke vene ne themel te gjykimit problematikat dhe veshtiresite ligjore qe hasin prokuroret ne punen e perditshme duke mos lene pas dore veshtiresite dhe problemet sociale te tyre.
7. Ofroj angazhimin tim maksimal për të krijuar një komunikim të dpd me prokuroret në detyrë të çdo shkalle gjykimi, me qëllim përcjelljen e problematikave reale pranë KLP me qëllim zgjidhjen e tyre.
8. Ne funksion te zbatimit te detyres do te bazohem në parimin e transparencës dhe bërjes publike të veprimtarisë së Prokurorisë dhe punës së KLP-së, me qëllim rritjen e besimit të publikut për punën e këtyre organeve.

Sqaroj se pikat e parashtruara janë vetëm një pjesë e asaj që unë çmoj se duhet të kem prioritet për të plotësuar kornizë të përgjithshme për mënyrën se si unë mendoj që funksionimi e KLP-së si institucioni më i lartë i Prokurorisë që normon dhe kontrollon punën dhe aftësitë e Prokurorëve të jetë mirëfunksional dhe të jetë në mbrojtje në radhë të parë të Prokurorëve që kanë vërtet një detyrë të vështirë , por dhe në mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetit dhe shtetasve duke forcuar në këtë mënyrë shtetin e së drejtës.

**PROKURORI**  
**Moisi Duda**

